



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2023:168600

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05519821

Ac.nr.6917/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Hidajete Gashi Alaj dhe Rafet Haxhaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F. A. nga Gjilani, Rr. “B. K.”, nr..., kundër të paditurës Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave, me objekt të padisë kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1054/2023, të datës 19.09.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 22.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit F. A. nga Gjilani, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1054/2023, të datës 19.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar C.nr.1054/2023, të datës 19.09.2023, ka vendosur si në vijim: Hedhet e palejuar padia e paditësit F. A. nga Gjilani, e ushtruar kundër të paditurës Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave, me objekt kontesti sistemimi në vendin e punës dhe kompensimi i dëmit material për paga mujore.

Kundër këtij aktvendimi, paditësi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e palës paditëse të aprovohet në tërësi si e bazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje dhe rigjykim.

Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjendet se e paditura të ketë parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditësit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me datë 07.08.2023, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensim dëmi, me pretendimet se i njëjti ka aplikuar në procesin rekrutues të shpallur nga Komuna e Gjilanit në pozitën e punës zjarrfikës dhe i ka përmbushur në tërësi kriteret e kërkuara dhe meqenëse i njëjti nuk është pranuar në këtë proces ka paraqitur ankesë në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, e cila ka nxjerrë vendim përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e paditësit. I pakënaqur me këtë vendim, paditësi ka parashtruar ankesë tek Inspektorati i Punës, i cili ka nxjerrë vendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e paditësit derisa paditësi përsëri ka parashtruar ankesë në shkallën e dytë të Inspektoratit dhe përsëri është refuzuar ankesa e paditësit si e pabazuar. Paditësi përmes padisë i është drejtuar gjykatës kompetente të shkallës së parë e cila ka nxjerrë aktgjykim me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka anuluar vendimin e të paditurës si të kundërligjshëm e nga të cilat arsye paditësi thekson se i është shkaktuar dëm material andaj përmes padisë ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësin ta sistemojë në vendin e punës dhe t'ia kompensojë dëmin material për paga mujore si dhe të obligohet e paditura me shpenzime procedurale.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.1054/2023, të datës 19.09.2023 e ka hedhur poshtë si të palejueshme padinë e paditësit duke e arsyetuar në kuptim të nenit 391, pika f) e LPK-së, me theksimet se paditësi në rastin konkret ka humbur të drejtën në mbrojtje gjyqësore, pasi padinë e ka parashtruar jashtë afatit ligjor e po ashtu gjykata ka parasysht faktin se paditësi, mjetet juridike i ka paraqitur në organet e sipërcekura të përshkruara si në padi, e për të proceduar më pas me incimin e konflikteve administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, e përmes të cilave edhe janë anuluar vendimet e kontestuara të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve-Inspektoriatit të Punës, dhe janë zëvendësuar këto akte me aktgjykimin e datës 02.05.2023 i formes së prerë prej 23006.2023, kurse paditësi është udhëzuar në kontest civil, por gjykata nga arsyet e cekura vlerëson se nuk e ndërprejnë afatin për ndjekjen e çështjes në gjyq, pasi në rastin konkret afatet e përcaktuara në nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës janë afate prekluzive, andaj mos shfrytëzimi i tyre ka si pasojë edhe humbjen e të drejtës për mbrojtje gjyqësore, dhe jo për shkak se kjo e drejtë i është mohuar paditësit, por për shkak se paditësi ka dështuar që me kohë t'i shfrytëzojë këto mjete juridike të cilat i kanë pasur në dispozicion.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkelje Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që me dispozitën e nenit 391, pika f) e LPK-së është paraparë se *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se.. pika f) padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj”*. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës, konstatohet se paditësi padinë në gjykatën e shkallës së parë e ka paraqitur me datë 07.08.2023, ndërsa Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, ka nxjerrë aktgjykimin e saj të fundit, A.nr.2095/22, me datë 02.05.2023, i cili ka marrë formë të prerë me datë 23.06.2023, ashtu që nga data e aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës e deri në datën e parashtrimit të padisë kanë kaluar mbi 30 ditë, ashtu që gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vlerësuar se padia e paditësit është paraqitur pas afatit ligjor. Kjo ngase me dispozitat ligjore nga neni 78 të Ligjit të Punës, është përcaktuar se *“ I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. 25 3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh”*, dhe paditësi është dashur që konform nenit 79 të Ligjit të Punës, në afatin vijues prej 30 ditësh, të inicioj kontest pune në gjykatë e kjo ngase me nenin 79 të Ligjit të Punës është paraparë se *“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”*, e nga interpretimi i të cilave rrjedh fakti se paditësi edhe pse ka pasur mundësi ligjore ti drejtohet me kohë gjykatës me padi për të kërkuar mbrojtje gjyqësore, një gjë të tillë nuk e ka bërë ndërsa afatet e përmendura në dispozitat më lartë janë afate prekluzive dhe mos shfrytëzimi i tyre në rastin konkret ka si pasojë edhe humbjen e të drejtës për mbrojtje gjyqësore. Gjykata e Apelit në rastin konkret të drejtën e paditësit për parashtrim të padisë e merr që nga momenti i plotëfuqishmërisë aktgjykimit të Gjykatës Themelore e Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2095/22, me datë 02.05.2023, përmes së cilit paditësi është udhëzuar në kontest civil, edhe pse paditësi që nga momenti i nxjerrjes së vendimit por mos pranin në konkursin e lartëpërmendur kishte mundësi që ti drejtohet të paditurës me ankesë në lidhje me vendimin për mos përzgjedhje dhe pas kalimit të afatit për vendosje në ankesë nga e paditura në kuptim të nenit 79 të ushtrorë padi në gjykatën kompetente dhe jo të ushtrorë ankesë pranë Inspektoriatit të punës, pasi që të njëjtët nuk janë kompetent për të vendosur në ankesat e tilla. Andaj, nisur nga kjo, gjykata e Apelit konstaton se padia e paditësit është ushtruar pas afatit të paraparë ligjorë.

Gjykata e Apelit i vlerësoj pretendimet ankimore të paditësit në lidhje me atë se i njëjti ka kërkuar edhe kompenzimin e të ardhurave personale dhe se afati i parashkrimit është tri (3) vite, por të njëjtat pretendime nuk i morri për bazë, pasi që në këtë çështje kontestimore është sistemimi në vendin e punës sipas konkursit të cekur si më lartë dhe më pastaj kompensimin e të ardhurave personale. Andaj, duke qenë se padia për sistemimin në vendin e punës është ushtruar pas afatit të paraparë ligjorë, fatin e të njëjtës e përciellë edhe kërkesa për kompensimin e të ardhurave personale.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, të paditësit, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.6917/2023, më datë 22.03.2024.

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,  
Besnik Bislímaj, d.v